



## TERMAT E REFERENCËS

<b>Emri i Projektit</b>	Qendra Mbështetëse për Fëmijë dhe Familje
<b>Lloji i shërbimit</b>	Trajner për punë dore me qëllim të shkathtësimit të përfituesve në punimin e veshjeve tradicionale me ar, punimit me penj dhe lesh, punimit me rruaza
<b>Vendndodhja</b>	Prishtinë
<b>Kohëzgjatja</b>	Janar 2025 – Dhjetor 2026
<b>Data e pritshme e fillimit</b>	Janar, 2025
<b>I raportohet</b>	Qendrës Mbështetëse për Fëmijë dhe Familje -SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

### Hyrje

Këto Terma të Referencës shërbejnë si një kërkesë për propozime nga individët e interesuar në udhëheqjen e punëtorive javore punë dore- qëndisje me përfituesit e Qendrës Mbështetëse të Fëmijës dhe Familjes – Prishtinë, me qëllim të ngritjes së shkathtësive të punës dhe pavarësimin e përfituesve në gjenerim të të ardhurave.

### SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Internacional është organizata ombrellë e federatës botërore të 118 shoqatave kombëtare të SOS Fshatrave të Fëmijëve, që veprojnë me programet e tyre në më shumë se 2500 vende në tërë botën. Ne punojmë bashkërisht me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familje dhe rritet me dashuri, respekt dhe i sigurt. Ne ofrojmë përkujdesje afatgjatë familjare, në mënyrë unike, për fëmijët që e kanë humbur kujdesin prindëror (shërbimi i kujdesit alternativ), dhe punojmë me familjet dhe komunitetet e cenueshme për t'u ndihmuar që të fuqizohen dhe ta parandalojnë braktisjen e fëmijëve (shërbimi për fuqizimin e familjes, SHF). SOS kujdesai alternativ zakonisht organizohet në formën e një grupimi të SOS familjeve, ku secili prind i SOS përkujdeset për një grup të vogël të fëmijëve. Që nga viti 2001, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ka vepruar në mënyrë aktive në fushën e mbrojtjes sociale duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta dhe të cilësisë së lartë të kujdesit ndaj fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdesje prindërore nëpërmjet zhvillimit të një mjedisi alternativ të kujdesit familjar dhe shërbimeve të bazuara në komunitet për familjet e rrezikuara. Në kuadër të programeve të SOS Fshatrave të Fëmijëve dhe atyre për fuqizimin e familjeve, ne punojmë së bashku drejt vizionit tonë për një botë ku “çdo fëmijë i përket një familje dhe rritet me dashuri, respekt dhe i sigurt”. SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë punon në partneritet me institucionet përgjegjëse, organet shtetërore, akterët kryesorë, organizatat kryesore dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale të fëmijëve në nevojë, dhe u krijon mundësi të rinjve që të përfshihen me kontributin dhe ndikimin e tyre në formësimin dhe hartimin e politikave dhe në zhvillimin e shërbimeve dhe programeve.



## **Konteksti i programit**

Që nga viti 2007, Programi i Fuqizimit të Familjes dhe Qendra Mbështetës për Femijë dhe Familje ofron shërbime psiko – sociale për përfituesit në Prishtinëë përmes aktiviteteve psiko-sociale, mbështetjes arsimore, mbështetjes në nevojat shëndetësore, avokimit për fuqizim të rrjetit të komunitetit për mbrojtje të fëmijëve në nevojë, si dhe ofrimit cilësor të shërbimeve në përputhje me nevojat. Programi punon me familjet e marxhinalizuara dhe ka për qëllim parandalimin e braktisjes së fëmijëve dhe shpërbërjen e familjes.

Qëllimi i projektit është që fëmijët të rriten në mirëqenje me prindërit dhe me familjet e tyre, në ambient të shëndoshë social.

Projekti ofron shërbime cilësore gjithëpërfshirëse, shërbime që ndihmojnë të përmirësojnë situatën ekonomike dhe do të jenë të vetë-qëndrueshme ekonomikisht duke punuar në zbulimin e aftësive të tyre profesionale. Në Prishtinë ofrohen shërbime për familjet në nevojë përmes këtyre komponentave; komponentës psikosociale, edukative , shëndetësore, ,pedagogjike dhe shtylla apo komponenta e fundit është komponenta e fuqizimit ekonomik të familjeve.

## **Përmbledhje e komponentes te fuqizimit ekonomik**

Në kuadër të komponentës së fuqizimit ekonomik të familjeve përfituese, zhvillohen shkathtësitë e punës dhe synohet pavarësimi i përfituesve në tregun e punës.

Fuqizimi ekonomik konsiderohet si një nga lidhjet e fundit në zinxhirin e mbështetjes që ne u ofrojmë familjeve, për të siguruar qëndrueshmëri, besim në vetvete dhe arritjen e qëllimit tonë përfundimtar për të thyer ciklin e varfërisë dhe fuqizimin e individëve për të marrë përgjegjësi mbi jetën e tyre dhe jetën të anëtarëve të familjes së tyre.

Fuqizimi Ekonomik ofron shërbime për prindër dhe të rinjë përmes:

- Aftësimi profesional – kurse të ndryshme në përputhje me shkathtësitë e përfituesve.
- Referim për punësim në veprimtari të ndryshme ekonomike.
- Shkëmbim përvojash në mes të përfituesve për qështjet e punësimit.
- Avokim për punësim të përfituesve.
- Mbështetje me mini-grante të vogla për përfituesit.
- Trajnime për zhvillim të njohurive dhe kapaciteteve që lidhen me fushën e gjenerimit të të ardhurave.

## **Objektivat dhe fushëveprimi**

Këto veprime kanë për qëllim identifikimin e shkathtësive dhe ndërtimin e shkathtësive të punës bazuar në nevojat individuale. Zhvillimi i shkathtësive në punimin e veshjeve tradicionale me ar, punimit me penj dhe lesh, punimit me rruaza (kjo përcaktohet varësisht nga interesimi i përfituesve) është një nevojë e identifikuar tek përfitueset e projektit.



Duke pasur parasysh të gjitha që u ceken më lartë, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë kërkon trajner individual që janë të interesuar të mbajnë trajnime dy herë në javë në Prishtinë, me dy grupe të ndryshme (secili grup me rreth 5 pjesëmarrës) për përfitueset e projektit. (orari përcaktohet para fillimit të punëtorive)

Punëtoritë planifikohet të zgjasin nga 2 orë në ditë per grup , gjithsej 4 orë në javë për të dy grupet.

### **Rezultatet e pritshme:**

- Pjesëmarrësit në punëtoritë javore ngrisin shkathtësitë e tyre në punimin e veshjeve tradicionale me ar, punimit me penj dhe lesh, punimit me rruaza (përcaktohet varësisht nga interesimi i përfitueseve)
- Pjesëmarrësit i ngrisin shkathtësitë në menaxhimin e materialit në dispozicion dhe përdorimin e tij në mënyrë racionale.
- Secili pjesëmarrës pas përfundimit të punëtorive do të zhvillojë dhe punojë një product unik

Gjatë punëtorive javore, trajneri duhet të respektojë kulturën e pjesëmarrësve, normat shoqërore, vlerat dhe sjelljet, si dhe të mbajë marrëdhënie të përshtatshme me pjesëmarrësit në grup. Trajneri duhet të respektojë konfidencialitetin e informacionit të siguruar gjatë punëtorive.

Trajneri i punëtorive duhet të jetë përgjegjës për:

- Organizimin e punëtorive;
- Koordinimin e orarit të përshtatshëm për përfituesit;
- Njoftimin me kohë për ndryshim të orarit;
- Mbajtjen e takimeve javore, mbajtjen e evidencës së pjesëmarrjes në secilin takim;
- Zhvillimin dhe krijimin e së paku tre produkteve unike të grupit;
- Mentorimin individual të përfitueseve, në bazë të nevojës;
- Raportimin mujor tek Këshilltari për Fuqizim Ekonomik në kuadër të Qendrës Mbështetëse

### **Metodologjia e punës**

Metodologjia e trajnimit duhet të jetë gjithëpërfshirëse (duke përfshirë të gjithë pjesëmarrësit, respektimin e moshës etj.), si dhe respektimin e normave dhe parimeve të shoqërisë dhe etikës profesionale.

Plani i punës së trajnimeve të cilat i ofron trajneri duhet të përmbajnë në detaje metodologjinë, hapat dhe procedurat se si do të realizohet trajnimi etj.

Metodologjia duhet të përfshijë por jo domosdo të kufizohet në informatat e cekura më poshtë:

- Të përshkruhen të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me definimin e metodologjisë së trajnimit,
- Të përpilohet një plan real i punës me afate kohore në përputhje me këto ToR,

Materialet e nevojshme për zhvillim të punëtorive sigurohen nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë.



### **Shkathësitë e kërkuara (Përvoja dhe Kualifikimet):**

- Përvojë të dëshmuar (të dhënat e përvojes paraprake) në angazhime të ngjashme
- Përvojë e dëshirueshme me target grupin e synuar;
- Të ketë së paku tri vjet përvojë në fushën e ngritjes së kapaciteteve
- Të ketë shkathësi të mira personale dhe ndër-personale për punë në ekip
- Të ketë shkathësi të shkëlqyeshme komunikuese
- Të ketë përvojë dhe punë të dëshmuar në sektorin e biznesit
- Duhet të jetë i njoftuar me standardet etike lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët dhe do t'u kërkohet që ta nënshkruajnë dhe t'i përmbahen Politikave për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Aftësi të demonstruar për të kryer trajnime përmes platformave online (nëse është e nevojshme).

Plani i punës së bashku me metodologjinë e propozuar të cilat i ofron trajneri duhet të përshkruajnë në detaje planin e punës dhe metodologjinë (metodat dhe mjetet e punës).

### **Dokumentet për tu dorëzuar:**

1. **CV;**
2. **Kopja e letërnjoftimit;**
3. **Letër motivimi;**
4. **Çertifikatat apo referencat të cilat dëshmojnë eksperiencën në fushëm relevante;**
5. **Oferta financiare duhet të deklarohet në euro bruto për një orë shërbimi.**

Vërtetimin të cilin nuk jeni nën hetime (dorëzohet para nënshkrimit të kontratës)

Oferta duhet të jetë e vlefshme për 30 ditë

Kriteret për përzgjedhje janë:

<b>Kriteret</b>	<b>Pikët maksimale</b>
• Trajneri i punëtorive duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune në zanatin e punë dorë dhe në angazhime të ngjashme me target grupin e synuar;	70
• Oferta financiare	30
<b>Totali</b>	<b>100</b>

### **Kohëzgjatja: Janar 2025-Dhjetor 2026**

Punëtoritë do të organizohen nga muaji Janar 2025 deri në Dhjetor 2026



### **Kushtet e pagesës**

Pagesa do të bëhet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, si pagese bruto në baza mujore dhe do konsiderohet si pagesë nga punëdhënësi i dytë, ndërsa ndalesa për tatim në të ardhurat personale dhe kontributi pensional do bëhet sipas ligjit në fuqi. Realizimi i pageses do bëhet në fund të çdo muaji në vartësi të orëve të realizuara dhe do të kryhet me transfer bankar, jo më vonë se 7 ditë nga pranimi i raportit mujor dhe evidencës së angazhimit.

### **Të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera pronësore**

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do të ketë të drejtën e të gjithë pronësisë intelektuale dhe të drejtave të tjera pronësore, por pa kufizime ndaj të drejtës së kopjimit, në lidhje me raportin, proceset, idetë, dokumentet dhe materialet e tjera që Kontraktori ka zhvilluar për SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, sipas kontratës, dhe të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me përgatitjen e gjetjeve.

Të gjitha materialet: planet, raportet, vlerësimet, rekomandimet, dokumentet dhe të gjitha të dhënat e tjera të hartuara nga Kontraktori ose të pranuar nga Kontraktori do të jenë pronë e SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë dhe do të trajtohen si konfidenciale dhe do të dorëzohen vetëm në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë në fund të punës sipas kontratës.

E drejta e kopjimit e produkteve do t'i përkasë SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë dhe individit/kompania nuk do të jetë i autorizuar t'i përdorë ose riprodhojë ato diku tjetër.

### **Shtojca - Politika e mbrojtjes së fëmijëve dhe kodi i mirësjelljes së SOS Fshatrave të Fëmijëve**

SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë kanë një politikë dhe kod të mirësjelljes për mbrojtjen e fëmijëve, nga konsulentët e ndërmarrjeve pritëse të respektojnë dhe do të kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë përkushtimi ndaj politikës. Kjo do të ndodhë me nënshkrimin e kontratës, së bashku me një orientim të kompanisë në proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve dhe rregulloret e mbrojtjes së të dhënave. Para fillimit aktual të mbledhjes së të dhënave, duhet të sigurohet një verifikim policor, në rast se planifikohen të dhëna të ndjeshme.

### **Udhëzim për ofertuesit (Procesi i dorëzimit të Ofertave)**

Ofertuesit janë të mirëpritur të paraqesin propozimin e tyre për "Trajner për punë dore" - në mënyrë elektronike në formatin PDF dhe në adresën elektronike [procurement1@soskosova.org](mailto:procurement1@soskosova.org). Propozimi dhe të gjitha dokumentet plotësuese duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.

### **Afati i fundit për dorëzim:**

Afati i fundit për aplikim është data: 06.12.2024 **deri** në mesnatë.